

INTERSIG

Vienna Insurance Group

Raporti vjetor 2016



VIENNA INSURANCE GROUP



VIENNA INSURANCE GROUP

Rreth Intersig VIG

- Intersig u themelua në vitin 2001 nga një grup aksionerësh vendas, të cilët u licensuan për sigurimet jo-jetë në Republikën e Shqipërisë.
- Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe nënshkroi një marrëveshje në Tiranë më 24 Gusht 2011 për të marrë shumicën e aksioneve së Intersig sha. Ky proces i rriti kompanisë kapitalin, cilësinë dhe kualifikimet e stafit.
- Aktualisht VIG zotëron 90% të aksioneve të Intersig Vig.
- Prania e VIG në Shqipëri realizohet nëpërmjet 2 kompanive, **Intersig VIG** dhe SigmaInterAlbanian Vig

Celesi I Suksesit

- Niveli menaxherial është i motivuar dhe me ambicje për të zhvilluar kompaninë dhe për të fituar një pjesë të rëndësishme të tregut të sigurimeve në Shqipëri.
- Personel të kualifikuar dhe me përvojë, profesionale, me njohuri dhe aftësi për shitjen e kryqëzuar të disa produkteve të sigurimit të adaptuara për tregun e brendshëm.
- Kujdes i veçantë i atribuohet klientëve dhe partnerëve tanë, në bazë të Standardeve Profesionale të Kompanisë.
- Likujdimi i menjëhershëm ndaj kërkesave të sigurimit dhe qëndrim i pamëshirshëm ndaj mashtrimit të sigurimit.

Vizioni:

Vizioni jonë është që të jemi kompania e sigurimit më e besuar dhe më e preferuar në treg

Misioni:

- Ne jemi të dedikuar për të qënë kompania lider në Shqipëri nëpërmjet produkteve konkurruese që ofrojmë dhe shërbimit cilesor.
- Ne kujdesemi për njerezit në vecanti.
- Ne jemi të përkushtuar për drejtësi, partneritet, respekt reciprok, transparencë dhe marrëdhënie të qëndrueshme.
- Kjo është ambicia jonë për të krijuar biznes më tërheqës dhe një mjedis pune të favorshëm për të siguruar suksesin tonë.
- Ne krijojmë vlera të qëndrueshme.
- Ne jemi të orientuar drejt rritjes së qëndrueshme dhe fitimprurëse, për të rritur më tej forcën tonë financiare.
- Ne kujdesemi që të jemi sa më pranë klientëve tanë duke u bazuar në praktikat më të mira në fusha të ndryshme të biznesit. Keto programe dhe praktika na sigurojnë nivelin më të lartë të shërbimit ndaj klientit dhe shërbime inovatore me kosto optimale.
- Ne jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë sociale, prandaj jemi të angazhuar me programe sociale dhe me projekte të dedikuara për ata me më pak fat në jetë dhe për ata që do të jenë në të ardhmen tonë-fëmijet tanë.

Rreth Intersig VIG

Drejtorët dhe Menaxhimi më 31 dhjetor 2016 jane:

Bordi Mbikqyrës

Z. Peter Hofinger	Kryetar
Z. Christoph Rath	Zv.Kryetar
Z. Michael Hack	Anëtar

Bordi drejtues

Z. Gentian Sula	Drejtor i Përgjithshëm
Znj. Fitnete Sulaj	Anëtar Bordi
Z. Fatmir Berdica	Anëtar Bordi

Aksioneret e Intersig VIG më 31 dhjetor 2016 jane:

- Vienna Insurance Group (AG WIENER VERSICHERUNG GRUPPE)	<u>89.984 %</u>
- Gentian Sula	<u>10.016 %</u>

THE LEADING
INSURANCE
SPECIALIST
IN AUSTRIA
AND CEE.

VIG
VIENNA INSURANCE GROUP



AUSTRIA

WIENER STÄDTISCHE
VIENNA INSURANCE GROUP

onau
VIENNA INSURANCE GROUP

S-VERSICHERUNG
VIENNA INSURANCE GROUP

SLOVAKIA

Kooperativa
VIENNA INSURANCE GROUP

KOMUNÁLNA POISTOVNA
VIENNA INSURANCE GROUP

POISTOVŇA SLOVENSKÉJ REPUBLIKY
VIENNA INSURANCE GROUP

BULGARIA

BULSTRAD
VIENNA INSURANCE GROUP

Life BULSTRAD
VIENNA INSURANCE GROUP

UKRAINE

КНЯЖА
VIENNA INSURANCE GROUP

Княжа
VIENNA INSURANCE GROUP

ГЛОБУС
VIENNA INSURANCE GROUP

MOLDOVA

DONARIS
VIENNA INSURANCE GROUP

БЕЛАРУСЬ

КУПАЛА
VIENNA INSURANCE GROUP

MACEDONIA

ОСИГУРУВАЊЕ МАКЕДОНИЈА
VIENNA INSURANCE GROUP

WINNER
VIENNA INSURANCE GROUP

Life WINNER
VIENNA INSURANCE GROUP

ITALY BRANCH

WIENER STÄDTISCHE
VIENNA INSURANCE GROUP

onau
VIENNA INSURANCE GROUP

POLAND

COMPENSA
VIENNA INSURANCE GROUP

InterRisk
VIENNA INSURANCE GROUP

POUSA-ŻYCIE
VIENNA INSURANCE GROUP

CROATIA

WIENER OSIGURANJE
VIENNA INSURANCE GROUP

ERSTE OSIGURANJE
VIENNA INSURANCE GROUP

ESTONIA

COMPENSA
VIENNA INSURANCE GROUP

БТА

GEORGIA

GPIA
VIENNA INSURANCE GROUP

IRROD
VIENNA INSURANCE GROUP

MONTENEGRO

Život WIENER STÄDTISCHE
VIENNA INSURANCE GROUP

BOSNIA HERZEGOVINA

WIENER OSIGURANJE
VIENNA INSURANCE GROUP

SLOVENIA BRANCH

WIENER STÄDTISCHE
VIENNA INSURANCE GROUP

HUNGARY

UNION BIZTOSÍTÓ
VIENNA INSURANCE GROUP

ERSTE BIZTOSÍTÓ
VIENNA INSURANCE GROUP

viennalife
VIENNA INSURANCE GROUP

LATVIA

COMPENSA
VIENNA INSURANCE GROUP

InterRisk
VIENNA INSURANCE GROUP

БТА

TURKEY

RAY SIGORTA
VIENNA INSURANCE GROUP

GERMANY

InterRisk
VIENNA INSURANCE GROUP

CZECH REPUBLIC

Kooperativa
VIENNA INSURANCE GROUP

ČPP
VIENNA INSURANCE GROUP

POJIŠTOVNA SLOVENSKÉ REPUBLIKY
VIENNA INSURANCE GROUP

VIG Re

ROMANIA

OMNIASIG
VIENNA INSURANCE GROUP

ASIROM
VIENNA INSURANCE GROUP

DE VIATA BCR ASIGURARI
VIENNA INSURANCE GROUP

SERBIA

WIENER STÄDTISCHE
VIENNA INSURANCE GROUP

LITHUANIA

COMPENSA
VIENNA INSURANCE GROUP

InterRisk
VIENNA INSURANCE GROUP

БТА

ALBANIA

Skopje InterRisk
VIENNA INSURANCE GROUP

INTERSIG
VIENNA INSURANCE GROUP

LIECHTENSTEIN

VIENNA-LIFE
VIENNA INSURANCE GROUP

Rreth VIG

Vienna Insurance Group (VIG) është shoqëri e mirëkonsoliduar në të gjitha linjat e biznesit dhe ofron një portofol të plotë produktesh dhe shërbimesh me fokus klientin. VIG përbëhet nga mbi **50** shoqëri dhe rreth **25'000** punonjës në **25** vende të botës. Grupi shënoi një xhiro vjetore prej rreth 9 miliard euro në prime në vitin 2016, duke forcuar pozitën lider në tregun e Austrisë dhe Evropës Qendrore e Lindore (CEE), ku VIG operon prej mbi 25 vitesh.

Zgjerim i suksesshëm i VIG në rajonin CEE

VIG ka një traditë prej më shumë se 190 vitesh në Austri. Fillimisht si sigurues lokal në vitin 1824, VIG u zhvillua në një grup ndërkombëtar sigurimi. Në vitin 1990, vizionarët në Wiener Städtische vunë re që rajoni CEE ofronte shumë mundësi dhe e shfrytëzuan rastin duke hyrë në tregun e ish-Çekosllovakisë. Shoqëria vazhdoi të zgjerohet gjatë viteve, nga Estonia deri në Shqipëri dhe nga Gjermania deri në Gjeorgji, duke mbuluar gradualisht të gjithë rajonin. Hyrja në tregun e Republikës së Moldavisë në vitin 2014 mbushi edhe boshllëkun e fundit me mbulim në rajonin CEE.

Aftësi të kombinuara për t'u bërë numri 1

VIG është ngjitur në majë të tregut të sigurimeve në shumë vende në vitet e shkuara. Me një strategji rritjeje të fokusuar dhe perspektivë afatgjatë, VIG krijoi një bazë solide që i siguroi pjesë tregu dyshifrore në shumë tregje.

Shifrat e performancës në rajon tregon se vendimi për zgjerim në CEE ishte i duhuri. Në 2016, tregjet e CEE gjeneruan rreth gjysmën e totalit të primeve të VIG prej afërsisht 9 miliard eurosh. Grupi vazhdon të besojë në potencialin që ofron rritja ekonomike konstante në rajon, që sjell me vete edhe rritjen e kërkesës për produkte sigurimi.

Rëndësia e rajonit u confirmua nga një tjetër vendim i Grupit në vitin 2008, për të ngritur në Republikën Çeke selinë e shoqërisë së risigurimit VIG Re si pjesë e Grupit.

Rreth VIG

Fokusi i përbashkët te biznesi

Vendimet më lart shënojnë rrugën e ndjekur nga VIG dhe forcojnë fokusin te sigurimi si biznesi kryesor. VIG ndjek një strategji sigurimi progresive dhe tejet të vetëdijshme për riskun që merr përsipër. Besueshmëria, besnikëria dhe qëndrueshmëria përkufizojnë marrëdhënien e VIG me partnerët e biznesit, punonjësit dhe ortakët.

Kjo qasje thelbësore pasqyrohet edhe në strategjinë e VIG për rritje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme dhe kreditueshmëri ekselente. Agjencia ndërkombëtare Standard & Poor e ka vlerësuar zhvillimin e VIG me A+ dhe me perspektivë stabël për shumë vite. VIG vazhdon të ketë vlerësimin më të mirë nga të gjitha shoqëritë në ATX, që është indeksi lider i Bursës së Vjenës.

Përkrah klientit

Besnikëria dhe afriteti me klientin janë faktorët bazë të suksesit të VIG. Punonjësit tanë i njohin më së miri nevojat e klientëve tanë dhe kjo është arsyeja që VIG u jep besim këtyre punonjësve dhe sipërmarrjes lokale.

Për të krijuar stabilitet dhe besim, Grupi zbaton një strategji me shumë marka (multi-brand) që bazohet te markat e konsoliduara dhe i bashkon nën ombrellën e Vienna Insurance Group. Kjo qasje mundëson edhe përdorimin e një larmie të madhe kanalesh distribucioni. Orientimi strategjik i shoqërisë karakterizohet nga një politikë konservative investimesh dhe ri-sigurimi.

Grupi Erste dhe VIG: bashkimi bën fuqinë

Grupi Erste është i ankoruar në Austri dhe është një nga aktorët kryesorë në rajonin CEE. Partneriteti strategjik ndërmjet Grupit Erste dhe VIG filloi në vitin 2008 dhe është rritur dhe forcuar në tetë vitet e fundit. Shoqëritë e Grupit VIG i ofrojnë Grupit Erste produkte, ndërsa degët e Grupit Erste i shesin VIG produkte sigurimi.

Rreth VIG

Grup me politikë stabël për dividendin

VIG është regjistruar në Bursën e Vjenës që nga viti 1994. Sot, VIG është një ndër shoqëritë kryesore në segmentin e primeve dhe ofron një politikë tërheqëse dividendi me raport pagese të paktën 30% të fitimeve të Grupit (pas taksave dhe interesave jokontrolluese) për aksionarët.

Rëndësia e zonës ekonomike të Evropës Qendrore dhe Lindore u përforcua me regjistrimin e Shoqërisë edhe në Bursën e Pragës në shkurt 2008. Tashmë, kuotat e VIG e kanë pozicionuar ndër shoqëritë kryesore.

Struktura e aksionarëve ka ruajtur stabilitetin që nga rritja e kapitalit në vitin 2005. Rreth 70% e kuotave zotërohen nga aksionari kryesor, Wiener Städtische Versicherungsverein. Pjesa tjetër e kuotave prej 30% janë në shitblerje të lirë në bursë.

Së bashku drejt më të mirës

Të gjitha shoqëritë e Grupit VIG punojnë që të tërheqin punonjësit më të talentuar dhe më inteligjentë. Si rezultat, identifikimi dhe zhvillimi i aftësitë individuale është prioriteti kyç i menaxhimit të burimeve njerëzore të shoqërisë. Promovimi i diversitetit është po aq i rëndësishëm, ashtu si krijimi i një kuadri që ofron mundësi të duhura zhvillimi për punonjësit. Arsyeja: VIG e ka të qartë se suksesi i vet ndërtohet mbi përkushtimin e 23 000 punonjësve të vet/

Për informacione të mëtejshme për Vienna Insurance Group, klikoni www.vig.com ose lexoni Raportin Vjetor të Grupit VIG.

Corporate Social Responsibility



Event Sociale 2016




- Intersig VIG ka nje fokus te vecante per mbeshtetje e aktiviteteve sociale. Vlen te permenden:
 - Mbeshtetja ndaj Shoqatave te Femijeve me Nevoja te Vecanta
 - Mbeshtetja e Juventus Junior Camp
 - Mbeshtetja e Konferences per Auditimin dhe Financen te organizuar nga Universiteti i Tiranes
 - Mbeshtetja ndaj aktiviteve te ndryshme kulturore

Event Sociale 2016




Tregu i Sigurimeve 2016



Janar - Dhjetor	Prime te Shkruara Bruto Vlera (ne mije Lek)			Deme te Paguara Vlera (ne mije Lek)		
	2015	2016	16/15-1	2015	2016	16/15-1
Sigurimi Jetes	1,027,442	977,932	-4.82%	188,384	182,324	-3.22%
Sigurimi i JoJetes	13,047,308	14,384,340	10.25%	3,449,707	4,093,765	18.67%
TOTAL	14,074,750	15,362,272	9.15%	3,638,091	4,276,089	17.54%


Ecuria e Intersig VIG 2016

Prime te Shkruara



Ecuria e Intersig VIG 2016

Deme te Paguara



Produktet tona

INTERSIG Vienna Insurance Group ofron një gamë të gjerë produktesh sigurimi, të dizenuara për individë, familje dhe biznese, për t'iu ardhur më pranë kërkesave dhe nevojave të klientëve:

1. Sigurimet Motorrike

1. TPL
2. Kufitare
3. Karton Jeshil
4. Kasko

2. Sigurimi Pasurise

1. Sigurimi i Prones
2. Sigurimet Inxhinierike
3. Sigurime te Bankave etj

3. Sigurimi i Shendetit

4. Sigurimi i Pergjegjesive dhe Garancive

5. Sigurime te Transportit, Aviacionit dhe te Marines

INTERSIG
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGURIMI I SHETËPISË
SOT ËSHTË I MUNDUR

50 EURO/në vit
OPERTË E LIMITUAR

**MBULIM
NË RAST
ZJARRI DHE
TËRMETI!**

**15
VJET
KËTU,
PËR
JUI**

**Sigurimi i shtëpisë me vlerë
deri në 100.000 euro është i mundur
duke filluar nga 50 euro në vit.**

Rr. Ismail Qemali, Sams Tower, Kat 2-të, Ish Blloku, Tiranë, Shqipëri, Tel: +355 4 2270576,
e-mail: info@intersig.al, www.intersig.al

Analiza Financiare



Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
NUS: K01910121
Ibrahim Rugova St. Sky
Tower 9/Floor
1001 Tirana, Albania

Tel: +35542419575
ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Interq Vienna Insurance Group sh.a

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Interq Vienna Insurance Group sh.a ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parase për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël me të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2016, dhe rezultatit e saj financiar dhe të fluksit e mjetëve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë audituar nga një tjetër auditues i cili ka lëshuar një opinion të pamodifikuar më 29 mars 2016.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përkrahur në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shoqëri, dhe kemi përmësuar përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Këshillit Mbikëqyrës për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar afërsinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Këshilli Mbikëqyrës është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, priten që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomaliave materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përputhje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha për afërsinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe Këshillin Mbikëqyrës të Interq Vienna Insurance Group sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raportet për agjensitë rregullatore - kërkesa e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë për marrzin e Afërsisë Paqese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike.

Në përputhje me kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, ne kemi lexuar skedulet suplementare shoqëruese të marzhit të Afërsisë Paqese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike. Këto Skedule Suplementare të përgatitura nga Drejtimi nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare. Informacioni financiar historik, prezantuar në Skedulë Suplementare shoqëruese të marzhit të Afërsisë Paqese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike përgatitur nga Drejtimi, është konsistent, në të gjitha aspektet materiale, me informacionin financiar vjetor të paraqitur në pasqyrat financiare të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2016. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e Skedulit Suplementare shoqëruese të marzhit të Afërsisë Paqese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike, në përputhje me Ligjin nr. 52/2014 "Mbi veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega Shqipëri

24 mars 2017
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Ekspert Kontabël i Regjistruar

24 mars 2017
Tiranë, Shqipëri

Analiza Financiare

Intersig Vienna Insurance Group sh.a Pasqyra e pozicionit financiar

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVET		
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	10 77,465	51,049
Depozita me afat me banka	11 802,261	845,853
Bono Thesari	12 581,951	477,579
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	13 76,609	48,422
Kostot e shtyra të marjes në sigurim	14 172,427	135,706
Aktive të risigurimit	15 732,673	754,156
Parapagim tatim fitimi	16 -	7,582
Aktive të mbajtura për investime	17 209,468	220,493
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe të		
trupëzuara	19 43,620	44,203
Aktive të tjera	18 78,963	39,207
Aksione në shoqëri të lidhura	20 7,974	7,974
Aktiv tatimor i shtyrë	38 -	4,561
TOTALI AKTIVEVE	2,783,413	2,636,787
DETYRIMET		
Detyrime për humbjet dhe shpenzimet e		
adhistimit të humbjeve	21 888,344	843,406
Rezerva për primet e paguara	22 734,773	707,618
Depozite e risiguresit	23 475,597	429,035
Borxh i varur	24 135,407	137,280
Detyrime ndaj shtetit	25 26,290	13,747
Detyrimet nga tatimi mbi të ardhurat	26 569	-
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	27 63,214	89,238
TOTALI I DETYRIMEVE	2,324,194	2,220,325
KAPITALI		
Kapitali themeltar	28 1,228,000	1,228,000
Rezerva e riskut të sigurimit	29 53,265	53,265
Humbje të mbartura	(822,047)	(864,803)
TOTALI I KAPITALIT	459,219	416,462
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	2,783,413	2,631,855

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 36 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtuesit e Shoqërisë më 22 mars 2017:



[Signature]
Ilir Shkalla
Drejtues Financiare

Analiza Financiare

Intersig Vienna Insurance Group sh.a

Pasqyra e fitim ose humbjes dhe te ardhurave te tjera përmbledhëse

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	2015
Prime të shkruara bruto	30	1,601,206	1,568,245
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara, neto	22	(74,644)	(79,471)
Prime të ceduara të risiguruesit	31	(686,064)	(821,614)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		840,498	667,160
Të ardhura të tjera	32	22,897	15,366
Të ardhura neto		863,395	682,526
Humbje dhe shpenzimet e rregullimit të humbjes	21	(367,954)	(357,782)
Dëme të sigurimit, neto		(367,954)	(357,782)
Kostot e marrjes në sigurim	33	(433,667)	(390,921)
Ndryshimi në kostot e shtyra të marrjes në sigurim, neto		36,722	8,818
Shpenzime administrative	34	(268,382)	(242,450)
Shpenzime të tjera të sigurimit të lidhura me to	35	(167,063)	(68,580)
Provizjon për borxhin e keq	13	(1,104)	1,086
Shpenzime të tjera		(48)	(549)
Të ardhura nga komisionet e risigurimit		385,848	423,376
Shpenzime operative		(447,694)	(269,220)
Të ardhura nga interesi	36	41,716	34,276
Të ardhura nga shoqëri të lidhura		-	-
Shpenzime financiare		(20,071)	(20,789)
Të ardhura nga kurset e këmbimit, neto	37	(13,923)	5,491
Të ardhura financiare, neto		7,722	18,978
Fitim para tatimit		55,469	74,500
Tatim mbi fitimin	38	(12,713)	(14,697)
Fitimi i vitit		42,757	59,803
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga tatimi mbi fitimin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		42,757	59,803

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 36 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Analiza Financiare

Intersig Vienna Insurance Group sh.a

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Kapitali themeltar	Rezerva	Humbje të mbartura	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	1,228,000	53,265	(924,606)	356,659
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin				
Humbja e vitit	-	-	59,803	59,803
Të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin, neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	-	-
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin, neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	59,803	59,803
Gjendja më 31 dhjetor 2015	1,228,000	53,265	(864,803)	416,462
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin				
Fitimi i vitit	-	-	42,757	42,757
Të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin, neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	-	-
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin, neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	42,757	42,757
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,228,000	53,265	(822,047)	459,219

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 36 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Analiza Financiare

Pasqyra e fluksit të parasë

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
	2016	2015
Fitim/(humbje) para tatim fitimit	55,469	74,500
Fluksi i parasë nga aktivitetet operative		
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlërësimi dhe amortizimi	21,646	22,833
Nxjerrja jashtë përdorimit	952	458
Fondi për zhvlërësim	-	(1,086)
Pjesa e fitimit të shoqëritë e lidhura sipas metodës së kapitalit	1,104	-
Shpenzime interesi	20,071	20,789
	99,242	117,494
Ndryshimi në :		
- Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	(29,290)	11,199
- Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	(36,722)	(8,818)
- Aktive të tjera	(44,688)	15,311
- Rezervën e risigurimit	21,483	(260,966)
- Rezervën teknike për dëme	49,869	263,176
- Primin e rezervës të pafituar	27,155	111,408
- Depoziten e risiguresit	46,562	84,512
- Detyrime të tjera	(13,482)	(30,055)
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	20,887	303,261
Interesa të paguara	(21,943)	(23,833)
Tatim mbi fitimin i paguar	-	-
Flukset monetare neto nga aktivitetet operacionale	98,185	279,428
Flukset monetare nga aktivitetet investuese		
Blerje aktivesh të trupezuara dhe të pa trupëzuara	(10,990)	(6,841)
Rritje në depozitat me afat	43,592	(110,521)
Blerje e bonove të thesarit	(104,372)	(252,271)
Blerje aksione në Shoqëritë e lidhura	-	(1,461)
Rritje investime në Shoqëritë e lidhura	-	(1,505)
Flukset monetare neto të përdorura nga aktivitetet investuese	(71,770)	(372,599)
Flukset monetare nga aktivitetet finacuese		
Të hyra nga borxhi i varur	-	-
Shlyerje e huasë	-	(98,417)
Flukset monetare të përdorura nga aktivitetet finacuese	-	(98,417)
(Ulje)/rritja neto nga mjetet monetare dhe ekuivalentet me to	26,415	(191,588)
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në fillim të vitit	51,049	242,637
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në fund të vitit (Shënimi 10)	77,465	51,049

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 36 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Raporti I Auditit te Brendshem



Departamenti i Auditit te Brendshem

Raporti Vjetor i Auditimit - 2016 Gjetjet dhe Rekomandimet

Date 31/12/2016

Te Audituar

Departamenti i Shitjeve
Departamenti i Administrimit
Departamenti i Demeve
Departamenti IT

Auditues

Shkelqim Zhurda
Drejtore i Departamentit te Auditit te Brendshem

1. Metodologjia dhe Problemet e Audituar

Ne perputhje me planin vjetor te auditimit te shoqerise INTERSIG gjate vitit 2016 jane audituar proceset qe lidhen me administrimin dhe shitjen e policave, trajtimin e demeve, risigurimin, financen dhe teknologjine e informacionit.

Periodha e audituar perfshin aktivitetet e mesiperme te realizuara ndermjet datave 01 Janar 2016 dhe 25 dhjetor 2016.

Puna audituese u fokusua ne analizimin e proceseve, risqeve dhe ne kontrollimin e dokumentave fizike dhe te dhenave te ruajtura nga sistemet SAP, E-INSURE dhe MSHM, intervistimin e punonjesve qe kryejne keto procese pune, te dhena nga Starbroker, si dhe ne informacione te tjera te marra nepermjet komunikimeve elektronike me email.

Metodat e kontrollit te aplikuara gjate auditimeve kane qene te alternuar, kontrolli i plote per probleme te caktuara dhe i pjesshem per agjente dhe drejtues te degeve ku u krye auditimi. Ne raste te vecante, ne varesi te gjetjeve dhe madhesise se riskut kontrolli u thellua duke zgjeruar periudhen e veprimtarise se audituar.

Referuar ndarjes se pergjegjesive te menaxhimit te inventareve te policave dhe shitjes se tyre, pervec analizimit te te dhenave ne zyre, Auditimi u perqendrua edhe ne Deget e kompanise, si dhe prane zyrave qendrore te INTERSIG.

Problemet qe u kontrolluan jane:

- a) Inventari i policave fizike duke krahasuar te dhenat ne sistemin MSHM dhe ne sistemin E-INSURE.
- b) Kontrolli i te dhenave per primet dhe kategorie te mjeteve, ne programin e Shitjes duke e krahasuar me te dhenat e programit MSHM.
- c) Mungesat e konstatuara per agjente dhe dege te vecanta ne rakordimet e zyres qendrore per inventarizimin e policave.
- d) Procedurat e shitjes dhe te administrimit te policave te sigurimit.
- e) Probleme te shitjes se policave jashte sistemit, te policave dublikate, ndryshime te kategorieve dhe rregjistrim me vonese ne sistemin e shitjes.
- f) Rakordimet e debitoreve per prime te paarketuara, duke u fokusuar ne afatet e maturitetit te tyre.
- g) Agjentet e larguar dhe problemet qe jane konstatuar per policat e padorezuara dhe detyrimet per primet e paarketuara ne kompani.
- h) Procedurat e marrjes ne sigurim dhe problemet lidhur me produktin Kasko.
- i) Procedurat e trajtimit te Demeve dhe funksionet e programit Edusoft per rregjistrimin dhe trajtimin e Demeve.

2. Lista e Gjetjeve

- 1) Jane gjetur raste te leshimit te policave dublikate me mungesa ne dokumentacion (polica origjinale, deklarata e klientit etj) te cilat jane leshuar nga disa agjente shitje.
- 2) Nga auditimi i demeve jomateriale (bodily injury) u konstatua se nga momenti i aksidentit deri ne dorezimin e kerkeses per demshperblim pergatitet vetem nje informacion paraprak lidhur me momentin e aksidentit dhe rasti lihet ne pritje deri ne momentin e ardhjes se kerkeses per demshperblim.
- 3) Gjate auditimit te trajtimit te demeve u konstatua se dokumentat fizike te disa prej dosjeve ndodheshin te shperndara, nje pjese ne VIG Service dhe nje pjese ne Kompani. Gjithashtu u konstatuan raste demesh, dokumentat e te cilave nuk jane skanuar dhe rregjistruar te plota ne formatin elektronik ne programin Edusoft.
- 4) Mungesa e egzaminimit fizik mjekesor te personit te demtuar ne aksident nga ana e grupit te mjekeve te Kompanise. Eshte i domosdoshem egzaminimi fizik i personit te demtuar nga mjeket e kompanise, vecanerisht per rastet qe paraqesin perkeqesim shendetit te klientit.
- 5) Per raset e demeve te zgjidhura me marreveshje, ne dosje mungon nje Relacion shpjegues dhe opinion i Drejtorise Juridike, ne te cilin te pershkruhen disa nga fazat dhe ecuria kryesore e trajtimit te dosjes, ecuria e mundshme te ceshtjes dhe risqet qe paraqet ajo per zgjidhje me marreveshje, per trajtimin e metejshem te dosjes, apo riskun e zgjidhjes me rruge gjyqesore.
- 6) Ne dosjet gjyqesore me padi regresit mungon nje njoftim drejtuar shkaktarit te aksidentit, per pjesemarrjen e tij ne seancat gjyqesore ose per prezencen e shkaktarit ne negociatat per lidhjen e akt-marreveshjes ndermjet perfituesit te demshperblimit dhe kompanise.
- 7) Ne raportet analitike te demeve ne programin Edusoft, shpenzimet e trajtimit te demit nuk paraqiten te ndara nga shuma e demshperblimit.
- 8) Afati i ruajtjes se informacionit ne sistemin e kamerave te sigurise eshte i pamjaftueshem.
- 9) Ne njesine e sherbimit te klientit VIG Service (Reception dhe Call Center) nuk u gjet nje liste e shkruar dhe e afishuar e dokumentave te nevojshme per hapjen e dosjeve sipas llojit se demit.
- 10) Gjate muajve shtator dhe tetor 2016 jane konstatuar vonesa ne rregjistrimin e dosjeve te sigurimit te shendetit si pasoje e rritjes se numrit te personave te cilet trajtohen me sherbim nga ky produkt.

PËRMBLEDHJE E PARIMEVE TË VLERËSIMIT DHE MONITORIMIT TË RREZIKUT NË SHOQERINË E SIGURIMEVE INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP

Një nga përgjegjësitë kryesore të menaxhimit të rrezikut të shoqërisë është të garantojë që detyrimet e marra nëpërmjet policave të sigurimit të mund të plotësohen në çdo kohë. Rëndësi e veçantë është vendosur në zgjerimin dhe optimizimin e vazhdueshëm të procesit të integruar dhe sistematik të menaxhimit të rrezikut të shoqërisë dhe krijimin e një kulture të përshtatshme të monitorimit të riskut

1. Proçesi i Kontrollit të Rreziqeve

a. Bazuar në analiza të kryera më parë nga shoqëria dhe të raportuara tek shoqëria mëmë Vienna Insurance Group, tre risqet kryesore me të cilat përballlet janë të listuara si më poshtë. Këto do të jenë rreziqet (përfshirë dhe kategoritë e nën-rreziqeve) tek të cilat do të fokusohet dhe analiza e vetëvlerësimit.

1. Risku i marrjes në sigurim – tarifimi i produkteve motorike është risku më i madh në këtë kategori. Për të menaxhuar këto rreziqe të sigurimit, shoqëria ka formuar rezerva për pagimin e përfitimeve të ardhshme të sigurimeve. Gjithashtu, përqëndrimi i portofolit tonë në produktet motorike (p.sh. mungesa e diversifikimit) sjell rrezikun e përqendrimit.
2. Risku operacional – rreziqet që vijnë nga pozicione të mbajtura nga persona kyç në procese dhe organizime janë fushat me më të lartë. Disa pozicione mbahen nga staf me njohuri ekskluzive. Nën riskun operacional, një pjesë të rëndësishme zë edhe risku i sistemeve të IT. Asetet e IT janë nën rrezik nga humbja apo dëmtimi fizik dhe humbja e informacionit. IT është e përfshirë në Planin e vazhdimësisë së aktivitetit.
3. Risku i tregut – fokusi jonë në këtë pikë janë risqet e kursit të këmbimit dhe të përqendrimit. Meqenëse kemi asete në valuta të huaja, ndryshimi në kursin e këmbimit shkakton që ato të jenë të çënuara. Një tjetër burim i riskut të tregut është përqëndrimi i portofolit të aseteve në një gamë të vogël instrumentesh financiare (depozita dhe bono).

b. Kuantifikimi i të paktën risqeve kryesore do të jetë etapa e dytë në këtë fazë. Do të llogarisim kapitalin që i duhet dedikuar një risku të caktuar.

c. Në fazën e planifikimit do të përcaktojmë kufinj të minimalë dhe maksimalë të rreziqeve. Njësite duhet të vendosin limitet e risqeve të cilëve ato do ti përmbahen. Në anën tjetër, Bordi ka përgjegjësinë të përcaktojë luhatjen e lejuar.

d. Në këtë fazë do të përcaktojmë se cilat risqe mund të ndermerren brenda kufinjve të përcaktuara, dhe cilat risqe duhet të shmangen/transferohen totalisht.

e. Në këtë fazë do të vendosim për metodat e mitigimit të rreziqeve që duam të transferojmë për të ulur efektin e këtyre risqeve dhe për t'i mbajtur risqet brenda limiteve të paracaktuara.

f. Deri në analizën e parë të plotë të vitit financiar 2016 do të kemi vendosur se sa shpesh duhet të monitorohen të paktën risqet kryesore. Sigurisht monitorimi i rregullt do të jetë praktika normale, por për të pasur nën vëzhgim sidomos risqet me efekt të madh nëse materializohen, do të vendosim për një monitorim të shpëstët (p.sh. të paktën cdo 3-mujor). Monitorimi bëhet për të parë nëse kemi arritur planin, nëse ekziston rreziku i materializimit të risqeve, dhe nëse risqet janë brenda limiteve të vendosura.

g. Në rast se nivelet e risqeve janë larg kufinjve të vendosura, do të merren masa për mitigimin e tyre, fillimisht me përgjigje/reagim nga departamenti përkatës dhe në përfundim me përgjegjësinë e Bordit për vendimet.

2. Prova e Rezistencës

Prova e rezistencës është një teknikë e cila përdoret për të matur ndjeshmërinë e shoqërisë ndaj ngjarjeve që kanë një probabilitet të vogël për të ndodhur, por që kanë një efekt të konsiderueshëm kur ato ndodhin. Dy metodat kryesore të këtij testimi janë analiza e ndjeshmërisë dhe analiza e skenareve.

Faktoret makroekonomike kanë një efekt të madh në këtë lloj testimi. Risqet si ato të tregut, të kreditit apo operacionale janë drejtpërdrejtë të lidhura me luhatjet në normat e interesave, cmimet e aseteve, dhe kursin e kembimit. Megjithatë, risku primar i shoqërisë, risku i sigurimit, nuk është i varur direkt nga këto ndryshime në ekonomi.

Prova e rezistencës do të fokusohet në keto pika, të cilat janë të karakterit të marrjes në sigurim dhe të investimit, dhe që do na ndihmojnë të kuptojmë mjaftueshmerinë e kapitalit të shoqërisë në keto rrethana të vecanta:

- h. Mbizotërimi i produkteve të caktuara në portofol
- i. Profitabiliteti sipas produkteve për të kuptuar burimin e përqindjes me të madhe të fitimit
- j. Përdorimi i menyrave të transferimit të riskut (psh. Risigurimi)
- k. Kohezgjatja e detyrimeve
- l. Përberja e aseteve (pasuri të paluajtshme, hua, obligacione etj.)
- m. Nderlidhja me kompani të grupit (psh. risigurime brenda grupit)

3. Rreziqet që do të analizohen

Rreziqet që planifikohen të analizohen gjatë vetëvlerësimit janë të kategorizuara si më poshtë:

Analiza e rreziqeve të lidhura me aktivitetin:

- a. Risku i marrjes në sigurim – do të analizohen tarifimi dhe mbulimet; pasiguria në eksperiencën e dëmeve të raportuara/paguara; toleranca që kemi për luhatjet në shpenzime (përfshirë këtu shpenzimet për dëme). Gjithashtu, do të analizohen varesia që kemi nga primet e përfituara me ndërmjetësim (brokerë); cmimet e risigurimit.
- b. Risku i provigjionimit – do të analizohen sa të sakta janë provigjionimet për prime dhe dëme, jetegjatesia e dëmeve dhe efekti i inflacionit në to.
- c. Risku i katastrofave – do të analizohet sa në gjendje jemi për të përballuar dëme të mëdha nga katastrofa natyrore apo të shkaktuara nga njeriu; grumbullimi i dëmeve në nivele jo-normale; shterimi i risigurimit.

Analiza e rreziqeve jo te lidhura me aktivitetin:

- a. Risku i normes se interest – do te analizohet efekti i luhatjeve te normes se interesit (sidomos renia ne periudha recesioni), e cila ka me shume impakt ne kthimet e investimeve ne obligacione, etj, dhe me pak ne vleresimin ne kohe te produkteve te jo-jetes.
- b. Risku i pasurive te paluajtshme – do te analizohet efekti i goditjeve ne cmimet e pasurive te cilat jane per vete-perdorim dhe atyre qe jepen me qera.
- c. Risku i kursit te kembimit – do te analizohet efekti qe ka rritja apo ulja e monedhes kombetare (Lekut), duke pare gjithashtu se sa te koordinuara jane jetegjatesite e asetave dhe detyrimeve ne bilanc.
- d. Risku i kreditit – do te analizohet efekti i falimentimit te risiguruesit, emetuesit te obligacioneve, te huamarresve, etj.
- e. Risku i perqendrimit – do te analizohet efekti i perqendrimit te asetave apo obligacioneve tek pala tjeter. Analizen mund ta realizojme ne pozicionin neto per nje pale tjeter, nese ajo ka nje ekspozim si ne anen e asetave ashtu edhe ne anen e obligacioneve ne bilancin tone financiar. Testimi do te filloje me analizimin e efektit qe falimentimi i pales tjeter me ekspozimin me te madh do te kishte ne kapitalin e shoqerise.
- f. Risku i likuiditetit – do te analizohet nese shoqeria ka fonde te mjaftueshme likuide ne rast te demeve te medha apo nje periudhe me vijueshmeri te rasteve te demeve.

4. Administrimi i Rrezikut Financiar

Shoqëria monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar që lidhet me operacionet e saj përmes analizave të brendshme të riskut të cilat përshkruajnë shkallën dhe rëndësinë e riskut. Këto risqe përfshijnë riskun e tregut (risku i monedhës, risku i normave të interesit), riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit. Shoqëria nuk përdor instrumenta financiarë derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku i një impakti financiar negativ si rrjedhojë e ndryshimeve të tregut të tilla si ndryshimet në kurset e këmbimit, në normat e interesit dhe ndryshime të tjera në çmime. Risqet e tregut krijohen për shkak të luhatjeve si në vlerën e aktiveve ashtu edhe të detyrimeve të mbajtura. Shoqëria ka përcaktuar politika dhe procedura për menaxhimin e riskut të tregut.

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione si në monedhën lokale ashtu edhe në monedha të huaja; ndaj edhe lind rreziku prej luhatjes së kurseve të këmbimit. Për këtë arsye, luhatjet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja mund të ndikojnë nivelin e kapitalit të aksionerëve si rezultat kjo i përkthimit të tij në monedhën lokale. Risku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet përmes përdorimit të parimit të përputhshmërisë së aktiveve me detyrimet.

Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve të ardhshme monetare të një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe nga risku që maturitetet e aktiveve që mbartin interes do të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes dhe që janë përdorur për të financuar këto aktive. Kohëzgjatja brenda së cilës norma e interesit e një instrumenti financiar qëndron e fiksuar përcakton edhe shkallën e riskut të normës së interesit ndaj të cilit ekspozohet instrumenti financiar

Risku i kredisë

Risku i kredisë i referohet riskut që pala tjetër do të dështojë në obligimet e saj kontraktuale duke rezultuar në humbje financiare për Shoqërinë. Përgjatë kursit normal të biznesit, teksa arkëtohen primet, këto fonde investohen për të shlyer obligimet e ardhshme të policave. Shoqëria ekspozohet ndaj riskut të kredisë përmes titujve të borxhit të mbajtur deri në maturim, depozitave me afat, të arkëtueshmeve të sigurimit dhe kundërpartitë e risigurimit. Shoqëria ka vendosur procedura të brendshme dhe udhëzime sipas të cilave partnerët e risigurimit duhet të kenë vlerësime BBB- ose më të larta sipas S&P, Moody apo AM Best dhe të plotësojnë kërkesat e VIG përsa i përket Rregullave të Sigurisë për Risigurimet. Shoqëria menaxhon ekspozimin ndaj riskut të kredisë në mënyrë të rregullt përmes monitorimit të ekspozimit ndaj titujve të borxhit dhe kundërpartitë e depozitave me afat.

Shoqëria menaxhon ekspozimin ndaj riskut të kredisë në mënyrë të rregullt duke monitoruar vazhdimisht të arkëtueshmet nga sigurimet.

Risku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Risku i likuiditetit është një risk i moderuar i brendshëm për aktivitetin e biznesit të Shoqërisë sepse disa prej aktiveve të blera dhe detyrimeve të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqëria do të kërkonte shuma të konsiderueshme brenda një periudhe të shkurtër duke tejkaluar kërkesat normale për mjete monetare, ajo mund të përballej me vështirësi për të siguruar çmime tërheqëse. Shoqëria menaxhon riskun e likuiditetit përmes monitorimit të vazhdueshëm të fluksit të parasë të parashikuar dhe atij aktual, duke përputhur maturitetet e aktiveve dhe detyrimeve financiare.

Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Struktura e kapitalit të Shoqërisë konsiston në kapital që i atribuohet mbajtësve të kapitalit të Shoqërisë, dhe përfshin kapitalin e paguar, rezervat dhe fitimin e mbajtur. Shoqëria menaxhon kapitalin për të siguruar që çdo vendndodhje të mbajë nivelet e kërkuara të kapitalit që siguron vijueshmërinë e aktivitetit dhe përputhshmërinë me kërkesat për kapital të rregullatorëve, ndërsa maksimizon kthimin ndaj aksionerëve përmes optimizimit të raportit të borxhit me kapitalin.

Rreziqe të tjera

Ndryshimet në rregulloret shtetërore për segmentet e biznesit në të cilat Shoqëria operon mund të prekin përfitueshmërinë e saj. Biznesi i sigurimeve është subjekt i mbikqyrjeve gjithëpërfshirëse dhe zhvilluese. Qëllimi kryesor i këtyre rregulloreve është mbrojtja e policëmbajtësve. Ndryshimet në ligjet dhe rregulloret aktuale të sigurimit mund të ndikojnë mënyrën me të cilën Shoqëria drejton aktivitetin e biznesit dhe produktet që ofron. Për më tepër, përshtatja dhe amendimi i herë pas hershëm i ligjeve të sigurimit ose rregulloreve mund t'i bëjë ato më kufizuese ose të rezultojnë në kosto më të larta sesa kërkesat korrente.

5. Administrimi i rrezikut të sigurimit

Shoqëria merr mbi vete rrezik të sigurimit përmes kontratave të sigurimit në të cilat merr parasysh rrezikun e humbjes nga personat apo organizatat që janë drejtpërdrejt subjekt i humbjes. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë që ka të bëjë me kohën, frekuencën dhe shkallën e dëmeve të lidhura me këto kontrata.

Shoqëria menaxhon rrezikun përmes strategjisë së risigurimit dhe të marrjes në sigurim brenda kontureve të një menaxhimi risku të përgjithshëm. Vendosja e çmimeve bëhet bazuar në trendet dhe përvojat e kaluara. Ekspozimi menaxhohet duke pasur të dokumentuar limitet dhe kriteret e marrjes në sigurim. Risigurimet realizohen për t'i lehtësuar Shoqërisë efektin e humbjeve të mundshme nga ngjarjet individuale të mëdha apo katastrofave si dhe për të siguruar akses te specialistë të riskut dhe asistencë në menaxhimin e kapitalit. Policat e risigurimit shkruhen me risigurues të aprovuar ose mbi bazën e një marrëveshje proporcionale ose mbi bazën e një marrëveshje të tejkalimit të humbjes.

Kapitali rregullator menaxhohet gjithashtu duke iu referuar rrezikut të sigurimit ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar.

Rreziqet më të rëndësishme vijnë prej katastrofave natyrore, ndryshimeve klimatike dhe katastrofave të tjera (ngjarje me frekuencë të ulët dhe shkallë dëmi të lartë). Rrezik i koncentruar vjen edhe prej një kontrate të vetme që i lëshohet policëmbajtësve të një tipi demografie të veçantë, brenda një zone gjeografike të caktuar ose tipeve të bizneseve tregtare. Ndryshueshmëria e rezultatit lehtësohet nëse portofoli përbëhet nga shumë rreziqe të ngjashme.

Menaxhimi rishikon vlerësimin për dëmet dhe supozimet duke u bazuar në zhvillimet e dëmeve aktuale dhe bën rregullimet e duhura në metodologjinë e vlerësimit të dëmeve. Në vitin aktual, ka pasur një besim më të madh ndaj metodologjive aktuariale të tilla si trekëndëshi i dëmeve.

Supozime dhe sensitiviteti


Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jo-jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën kuantitative të sensitivitetit. Shoqëria përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë treguesë të tillë si raporti i humbjes së pritur.

Shoqëria e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për dëmet e jo-jetës në sigurim që njihen në pasqyrat e vecanta të pozicionit financiar. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur.

Rekomandime dhe masat

Strukturat përgjegjëse, të krijuara për të ushtruar funksionin e administrimit të rrezikut më qëllim vlerësimin, pranimin dhe admisnitrmin e rrezikut, raportojnë periodikisht për rreziqe me vlerë të madhe që mund të ndikojnë në aktivitetin e ardhshëm të shoqërisë.

Objektiva te te Ardhurave nga Primet



	2015	2016	2017
■ Sigurime Vullnetare	449,062,786	452,507,260	486,100,000
■ Sigurime te Detyrueshme	1,119,182,195	1,148,699,101	1,151,000,000
■ Total	1,568,244,981	1,601,206,362	1,637,100,000

	<u>2015</u>	<u>2016</u>	<u>2017</u>
Sigurime te Detyrueshme	71.4%	71.7%	70.3%
Sigurime Vullnetare	28.6%	28.3%	29.7%